



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 247/4 prot.

Tiranë, më 05. 05.2025

V E N D I M

Nr. 107, datë 05 . 05 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën¹ me nr. 26 Regj, datë 04.02.2025, paraqitur nga z. F. H. kundër Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin e fëmijës së tij të mitur F. H., për shkak të “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, z. F. H., ndër të tjera informon se: *“Quhem F. H.. Jam babai i 2 fëmijëve përkatësisht të moshës 18 dhe 13 vjeç. Të dy fëmijët i kam nxënë shkollë. I madhi studion në vit të tretë në shkollë profesionale, kurse tjetri është nxënë pranë shkollës 9-vjeçare “Ismail Qemali” në klasën e shtatë. Po ju drejtohem ju si institucion për problematikën që kam hasur në lidhje me përfitimin e bursës për djalin tim. Jam familje që trajtohem me ndihmë ekonomike. Në muajin tetor 2024 lajmërohem nga mësuesja kujdestare e djalit për të përgatitur dokumentacionin e kërkuar për të përfituar nga VKM 66. Filloj përgatitjen e dokumentacionit dhe e çoj në shkollë. Mësuesja kujdestare e djalit i sheh dokumentat dhe më thotë që çdo gjë ishte në rregull. Në muajin janar shoh që emri i djalit nuk ishte në listën e shpallur. Për këtë arsye komunikoj me mësuesen dhe më thotë që jam skualifikuar pasi nuk kam dokumentacionin e punëkërkesit të papunë. I tregoj përsëri situatën ku nga ana e saj ishte thënë që çdo gjë ishte ok, por ajo më tha që nuk ishte në dorën e saj, por në kompetencat e bashkisë. Ajo është marrë me dokumentacionin për përzgjedhjen. Shkoj dhe kontaktoj juristen pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të*

¹ Plotësuar përmes e-mail-it datë 30.12.2024

Arsimit dhe Çerdhes, të cilës i shpjegoj me detaje situatën, ku i tregoj që nëse je përfitues i ndihmës ekonomike, automatikisht je dhe punëkërkuar i papunë dhe kur i kam dorëzuar dokumentet në shkollë, mësuesja nuk ma vuri si kusht kryesor mungesën e këtij dokumenti, por më tha që çdo gjë ishte në rregull. Nuk jam lajmëruar përsëri nga kjo e fundit apo nga institucioni që unë të shkoja dhe aplikojta pranë e-Albania për të marrë këtë dokument, por përgjigja e saj ishte e prerë. Ia kërkoja dhe me shkrim që të më jepte dhe me shkrim arsyen. Është hera e dytë që unë i drejtohem institucionit tuaj, pasi dhe vitin e kaluar unë nuk kam qenë përfitues sepse trajtohesha me ndihmë ekonomike, dhe pse kisha dorëzuar vërtetimin si punëkërkuar i papunë. Këtë vit ndodhi e kundërta. Shoh se nga ana e këtij institucioni nuk ka korrektësi në dokumente, gjë e cila nuk u është vënë në dijeni nga mësuesit në fillim të procedurës. (Mesa shoh, kjo është lojë që shumë veta, edhe pse gëzojnë statusin familje që trajtohen me ndihmë ekonomike dhe përmbushin “kriterin ekonomik”, nuk janë përfitues, sepse numri i aplikimeve është më i madh sesa numri i bursave.) Po ju drejtohem ju si institucion që të më zgjidhni problemin, pasi kam besim të plotë në punën tuaj.”

Ankuesi ka kërkuar nga Komisioneri, konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e bursës për fëmijën e tij.

Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

1. Me shkresën nr. 247/1, datë 06.02.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:
 - Argumentimin Tuaj, lidhur me pretendimet e ankuesit.
 - Kopje të dosjes të dokumentacionit të dorëzuar nga ankuesi.
 - Informacion nëse fëmija e ankuesit (F. H.) ka përfituar vitet e kaluara pagesë burse. Nëse po, kopje të aktit/dokumentit provues.
 - Informacion mbi arsyet se përse fëmija i ankuesit; F. H., nuk ka përfituar bursë për këtë vit shkollor 2024-2025.
 - Si dhe çdo informacion tjetër që ju do e gjykoni të arsyeshëm dhe do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.

- Me shkresën nr.153 prot., datë 17.02.2025², Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë në mes të tjerash informoi Komisionerin se:

“Z. F. H., ka kërkuar bursë për fëmijët e tij F. H., nxënës në shkollën “Ismail Qemali” Korçë. Sipas informacionit nga Drejtoria e Shkollave, prindi ka dorëzuar dokumentet për të aplikuar për bursë, pranë kësaj drejtorie. Nga shkolla janë pranuar dokumentet dhe janë dorëzuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes. Nga ana jonë dokumentacioni i dorëzuar është pranuar dhe është shqyrtuar së bashku me të gjitha dokumentet e tjera të të gjithë nxënësve që kanë aplikuar për bursë.

Nxënësi nuk kanë qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2024-2025, pasi dokumentet që ka dorëzuar për aplikim nuk mund të klasifikohet në asnjë nga kriteret për përfitimin e bursës sipas VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar . Ankuesi pretendon se duhet të përfitojë bursë sipas kriterit 2.3/d, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar sepse ka djalin tjetër me aftësi të kufizuara. Por në këtë pikë thuhet shprehimisht: d) “Nxënës fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit” dhe dokumentacioni që kërkohet për të aplikuar për bursë sipas këtij kriteri është:

- *Certifikatë personale;*
- *Certifikatë familjare*
- *Vërtetim nga shkolla*
- *Vërtetim mbi statusin e invaliditetit dhe pagesën e pensionit të invaliditetit të prindërve;*
- *Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo person madhor të familjes.*

Bazuar në në këtë pikë nxënësi F. H., nuk mund të jetë përfitues i bursës sipas këtij kriteri, pasi mbështetur në dokumentacionin e dorëzuar pranë nesh, asnjëri nga prindërit nuk gëzon statusin e invaliditetit.

Po ashtu nxënësi nuk mund të jetë përfitues edhe sipas kriterit 2.1/c, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, pasi nuk ka vërtetimet nga zyra e punës për të dy prindërit.

Mungesa e këtij dokumentacioni ka qenë dhe shkak pse nxënëset nuk kanë qenë përfituese të bursës për vitin shkollor 2024-2025. Për të qenë përfitues i bursës duhet të kishin dorëzuar të gjitha dokumentet e sakta që kërkohen sipas kriterit në të cilin klasifikohen, si dhe duke respektuar afatet kohore për dorëzimin e këtij dokumentacioni. Për vitin shkollor 2024-2025 skualifikimet nga bursat kanë qenë për mungesë dokumentacioni/dokumentacion i pasaktë ose i korrigjuar dhe dokumentacion i dorëzuar jashtë afatit”.

Përsa i përket kërkesës suaj për informacion në lidhje me faktin nëse nxënësi ka përfituar apo jo bursë vitin e kaluar, shpjegojmë se edhe vitin e kaluar, nxënësi nuk kanë qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2023-2024, pasi dokumentet që ka dorëzuar për aplikim ka qenë i paplotë.

2. Në mbështetje të neneve 78-86 të Kodit të Procedurave Administrative, nenit 32, pika 1, shkronja c), dhe pikat 2, 3 e 4 të këtij neni, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për

² Administruar pranë Komisionerit me nr. 247/2 prot..., date 19.02.2025

Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nenit 39, të Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi³”, si dhe në zbatim të Urdhrit nr. 29, datë 05.03.2025, të Komisionerit, në datën 13.03.2025, nga inspektorët e KMD-së, u realizua inspektimi në ambientet e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë.

Objekti i inspektimit ishte marrja e informacionit të nevojshëm dhe dokumentacionit respektiv, në kuadër të shqyrtimit administrativ të kësaj çështjeje⁴.

Gjatë takimit me përfaqësueset⁵ e Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, u mbajt procesverbali përkatës, në të cilin u evidentua se:

- Dokumentacioni i kërkuar për përfitimin e bursës, sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, nuk bazohet në asnjë akt shkresor të hartuar apo dalë nga ana e NSHMAÇ/Bashkia Korçë apo Bashkia Korçë, por është vendosur sipas interpretimit që Ndërmarrja, i ka bërë kriteret të kësaj VKM-je.
- Nuk ka një procedurë konkrete të përcaktuar lidhur me shqyrtimin e trajtimit të dosjeve të aplikantëve për përfitimin e bursës, por nga praktika e krijuar prej tyre, kur gjatë shqyrtimit të dosjeve kanë konstatuar mungesë ose pasaktësi dokumentacioni, kanë kontaktuar verbalisht me drejtoritë e shkollave dhe u janë dhënë udhëzimet rast pas rasti, sipas specifikës të secilës dosje. Drejtoritë më pas kanë lajmëruar prindërit për plotësimin e dokumentacionit dhe u është lënë një afat i arsyeshëm për plotësimin e dorëzimit të tyre.
- Përgjegjësia për plotësimin e dorëzimit të dokumentacionit është e vetë prindit aplikant dhe nuk është përgjegjësi e Ndërmarrjes për ta siguruar, pavarësisht faktit nëse dokumentacioni disponohet nga institucionet vartëse të Bashkisë.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm.

³ <https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2021/05/RREGULLORE-KMD.pdf>

⁴ “Kopje të aktit ku është përcaktuar dhe miratuar lista e dokumentacionit që duhet të depozitohet një aplikant për përfitimin e bursës.

A ka një procedurë të miratuar lidhur me mënyrën si realizohet shqyrtimi i aplikimeve për përfitimin e bursave dhe afatet kohore? Nëse, po kopje të aktit/dokumentit përkatës ku është e përcaktuar procedura e shqyrtimit. Nëse nuk ka një procedurë të shkruar, informacion të detajuar se si realizohet në praktikë shqyrtimi i aplikimeve për bursë.

Kopje të urdhrit për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e aplikimeve për përfitimin e bursave për vitin 2024-2025.

Si dhe çdo parashtrim e dokument, apo akt tjetër provues, që vlerësoni se ndihmon në sqarimin e problematikës së ngritur nga subjektet ankues.”

⁵ Znj. S. Z, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Ekonomik, znj. K. Z, me detyrë Specialiste në Sektorin e Prokurimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe znj. T. H, me detyrë Psikologe pranë NSHMAÇ.

Subjekti ankues, pretendon se, në shkelje të pikës 2.1/c, të VKM-së nr. 511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, se fëmija i tij, si pjesë e kategorisë përfituese të bursës për vitin shkollor 2024-2025, është trajtuar në mënyrë të padrejtë e të pafavorshme nga Bashkia Korçë (Ndërmarrja), me arsyetimin e mungesës së dokumentacionit Vërtetim regjistrimi si punëkërkuar i papunë për çdo anëtarë madhor të familjes. Kërkimi i subjektit ankues para KMD-së lidhet me konstatimin e diskriminimit dhe përfitimin e bursës për fëmijën e tij.

Në kontekst të legjitimitetit të ankuesit kundrejt subjektit ndaj të cilit ka pretenduar diskriminimin, Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë, Komisioneri vëren se, bazuar në kompetencat e sanksionuara nga ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, Bashkia Korçë gëzon legjitimitet pasiv në këtë proces, pasi ka tagrin (si entitet) për miratimin e dhënien e bursave.

Nga ana tjetër, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes Korçë/Bashkia Korçë (Ndërmarrja), nuk gëzon legjitimitet pasiv për pretendimin e ankuesit për diskriminim lidhur me mospërfitimin e bursës për F. H., fëmija i tij, pasi nuk ka tagrin e miratimit të dhënies së bursës.

Bazuar në rolin tejet të veçantë dhe specifik që ka Ndërmarrja, si një hallkë shumë e rëndësishme lidhur me zhvillimin e gjithë procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve përfitues të bursës, pavarësisht faktit se nuk është vendimmarrëse, Komisioneri do të shqyrtojë edhe veprimet e Ndërmarrjes dhe ndikimin që ato kanë pasur tek vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin/mosmiratimin e bursës. Në mënyrë direkte, e gjithë vendimmarrja e Bashkisë lidhur me miratimin e dhënies së bursave është e bazuar në procedurën e zhvilluar nga NSHMAÇ dhe e kufizuar në listën e aplikantëve përfitues, të përcjellë prej saj.

Në këtë kontekst, Komisioneri, do të marrë në shqyrtim pretendimin e ankuesit, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm të fëmijëve të saj nga ana e Bashkisë Korçë.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, në nenin 1, të tij përcakton se: “Ky ligj rregullon organizimin dhe funksionimin e njësive të vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë, si dhe përcakton funksionet, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse”.

Neni 9, pika 1.1/ç), i Ligjit⁶, përcakton se: “1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi: 1.1. Të drejtën dhe përgjegjësinë e vetëqeverisjes, sipas së cilës: ...ç) krijojnë njësi ekonomike dhe institucione në varësi të tyre”.

⁶ Referuar ligjit sipërcituar me nr. 139/2015, i ndryshuar.

Në nenin 24⁷, i Ligjit, përcakton se, bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve, ndër të tjera dhe: “... *Krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit, etj. sipas mënyrës së përcaktuar me ligj*”.

Instrumentet për administrimin e shërbimeve publike, janë përcaktuar në nenin 33, të Ligjit, duke parashikuar se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore sigurojnë dhënien e shërbimeve publike, nëpërmjet një ose më shumë instrumenteve të mëposhtme:

- a) njësi organizative të veta, që janë pjesë e strukturës administrative të njësisë vendore;*
- b) ndërmarrjeve për shërbimet publike, sipas legjislacionit në fuqi;*
- c) kontraktimit të dhënies së shërbimeve me palë të treta;*
- ç) përdorimit të instrumenteve të përshtatshme të partneritetit publik dhe privat, sipas legjislacionit në fuqi;*
- d) krijimit të shoqërive tregtare në pronësi apo bashkëpronësi të njësisë vendore, sipas legjislacionit në fuqi.*

.....

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të ofrojë mbështetje financiare për ndërmarrjet bashkiake për shërbimet publike dhe/ose për shoqëritë tregtare me kapital të njësisë së vetëqeverisjes vendore, fusha e veprimit të së cilës lidhet me dhënien e një shërbimi publik që është përgjegjësi e kësaj njësie.”

VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:

...4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.

...

⁷ Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale

8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6, të këtij vendimi, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi.”

VKM nr. 511, datë 27.7.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:

“23. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat, si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe administrative të shkollave/konvikteve, ku nxënësit studiojnë....”.

Në këtë kuptim, bazuar në sa më sipër, Komisioneri do vijojë trajtimin e ankesës duke analizuar faktin nëse fëmija i ankuesit plotëson kushtet për përfitimin e pagesës për nxënësit e arsimit parauniversitar bazë në institucionet arsimore publike, në zbatim të pikës 2.1/c, të VKM-së sipërcituar, si dhe, nëse skualifikimi i tij (për mangësi në dokumentacionin e dorëzuar) është i drejtë dhe i bazuar ligjërisht.

Në analizë të legjislacionit, dokumentacionit dhe informacionit të depozituar nga palët, Komisioneri vëren se:

Bazuar në deklaratimet e palëve, pranohet fakti se, fëmija i ankuesit, nuk kanë përfituar bursë edhe për vitin shkollor 2023-2024, për të cilin Komisioneri është shprehur me Vendimin nr. 141, datë 20.05.2024.

VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, parashikon se:

“2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

.....

2.1 Kriteri ekonomik:

.....

c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.”.

Për të qenë përfitues të bursës për vitin shkollor 2024-2025, sipas klasifikimit në kriterin 2.1/c, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, dokumentacioni që kërkohet për të aplikuar për bursë sipas këtij kriteri, nga Bashkia Korçë, është:

- Certifikatë personale;

- Certifikatë familjare;
- Vërtetim nga shkolla (për regjistrim, frekuentim të rregullt dhe jo mbetës);
- Vërtetim të ardhurash/page për çdo anëtarë madhorë të familjes;
- Vërtetim regjistrimi si punëkërkuar i papunë për çdo anëtarë madhor të familjes;
- Vërtetim pagese pension pleqërie;
- Vërtetim nga tatimet që ka/nuk ka biznes për çdo person madhor të familjes.

Me shkresën me nr. 1035/1 prot., datë 02.12.2024, të NSHMAÇ, është urdhëruar ngritja e grupit të punës për shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumenteve të aplikimeve për bursë. Nuk rezulton që Bashkia të ketë një akt shkresor specifik e konkret, mbi bazën e të cilit të jetë mbështetur e të ketë zbatuar për përcaktimin e dokumentacionit të kërkuar për t'u dorëzuar nga aplikantët për bursë, por ka deklaruar se, është bazuar në interpretimin e kriterëve të VKM-së, si dhe në praktikën e saj të viteve të mëparshme.

Referuar dokumentacionit të depozituar nga palët dhe deklarimeve të tyre, rezulton se, pranë NSHMAÇ/Bashkia Korçë është depozituar dokumentacioni i kërkuar, brenda muajit tetor 2024. Për vitin shkollor 2024-2025, tre fëmijët e saj të cilët ndjekin arsimin bazë, nuk kanë përfituar bursë nga fondet e Bashkisë, me arsyetimin se, dokumentacioni i dorëzuar ishte i paplotë. Arsytet se përse nxënëset nuk kanë qenë përfituese të bursës për vitin shkollor 2024-2025, ishin se ankuesja nuk kishte depozituar *“Vërtetim regjistrimi si punëkërkuar i papunë për çdo anëtarë madhor të familjes”*.

Duke analizuar sa më sipër, Komisioneri gjykon se arsyetimi i Bashkisë për mos kualifikimin e nxënësit F. H. (fëmija i ankuesit) si përfituese të bursës për vitin shkollor 2024-2025, për arsyen e mësipërme është i pajustificuar, i padrejtë dhe i pa bazuar në fakte e prova, bazuar në arsyetimin e mëposhtëm:

- *Së pari*, Bashkia është në dijeni të kushteve ekonomiko-sociale të familjes së nxënësit, pasi ata rezultojnë aplikuese të bursës edhe për vitet e mëparshme shkollore. Lidhur me këtë, Komisioneri është shprehur edhe me Vendimin nr. 141, datë 20.05.2024, kundër Bashkisë Korçë.
- *Së dyti*, po ashtu, qëndrimi i Bashkisë se, *“ankuesi nuk kishte depozituar Vërtetim regjistrimi si punëkërkuar i papunë për çdo anëtarë madhor të familjes”*, është i pajustificuar dhe jo objektiv, përse kohë që, z. H. rezulton përfituese e pagesës së ndihmës ekonomike, pagesë e cila i akordohet atij nga vetë Bashkia.

VKM Nr. 597, datë 4.9.2019 *“Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”*, në ndarjen I, pika 2 parashikon ndër të tjera se: *“2. Përfituesit e ndihmës ekonomike janë: a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme;...”*.

Në ndarjen II, të VKM-së “Procedura e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike”, parashikohet se: “1. Administratori shoqëror identifikon familjet dhe individët në nevojë, i informon ata mbi procedurat e aplikimit dhe të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe i fton ata për aplikim. Administratori shoqëror, në prani të kryetarit të familjes/anëtarit madhor, së bashku me bashkëshortin/en, ose të vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kur aplikon për ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit, të dhënat e mëposhtme:

a) Formularin për aplikim për ndihmë ekonomike, sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si pjesë përbërëse e tij, dhe që përmbledh informacionin për:

- i) demografinë e familjes, arsimin dhe punësimin;
- ii) llojin e banesës;
- iii) pasuritë/asetet familjare;
- iv) të ardhurat nga programet e mbrojtjes shoqërore dhe të ardhurat e tjera.

2. Administratori shoqëror, pasi verifikon situatën social ekonomike të familjeve në nevojë nëpërmjet vizitave në familje dhe në terren, brenda muajit të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për të gjitha familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike, hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar të dhënat sipas formularit në shtojcën 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij...

3. Administratori shoqëror paraqet pranë strukturës përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki, nëpërmjet Regjistrit Elektronik Kombëtar, listën e familjeve/individëve në nevojë që kanë aplikuar për ndihmë ekonomike;

4. Anëtarët madhorë të familjes/individët përfitues paraqiten çdo 3 (tre) muaj pranë administratorit shoqëror për të deklaruar lidhur me gjendjen social-ekonomike të familjes. Administratori shoqëror hedh në Regjistrin Elektronik Kombëtar deklaratën lidhur me ndryshimet e situatës social-ekonomike të familjes, sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për përfitimin e ndihmës ekonomike...

.....

8. Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, për realizimin e procesit të vendimmarrjes për përfituesit e ndihmës ekonomike, ka këto përgjegjësi:

.....

c) ia dërgon vendimin kryetarit të bashkisë:

- i. për të njoftuar kërkuessit për përfitimin e ndihmës ekonomike;
- ii. për të kryer veprimet financiare për pagesën për përfituesit e ndihmës ekonomike...”.

- Pra, bazuar në sa më sipër, Bashkia përmes strukturave vartëse të saj, ndjek procesin e aplikimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, ku pjesë e procesit të verifikimit janë edhe të ardhurat e familjeve që kanë aplikuar. Gjithashtu, familjet përfituese të ndihmës ekonomike, i nënshtrohen verifikimit çdo 3 (tre) muaj, nga ana e administratorit shoqëror, lidhur me ndryshimet e situatës social-ekonomike të familjes. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, kërkitimi i këtij dokumenti, i cili disponohet nga ana e saj, dhe bazuar mbi të cilin njeh dhe bën pagesën e ndihmës ekonomike për familjen e z. F. H., është një pengesë e shtuar dhe barrë e tepërt për aplikantin

për efekt të përfitimit të bursës bazuar në kriterin 2.1/c, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar.

- Pra, përfundimisht, Komisioneri vlerëson se, fëmija i ankuesit (F. H.), bazuar në kriterin ekonomik të VKM-së përkatëse, duhet të ishin përfituese të bursës, si nxënës, fëmijë të familjeve në nevojë, që është regjistruar në arsimin bazë, por në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë, njohur dhe dëshmuar me dokumentacion nga ana e Bashkisë Korçë.

Sa më sipër Komisioneri vlerëson se, deklaratimet e veprimet e Bashkisë Korçë, nuk qëndrojnë, janë të paarsyetuara, jo objektive dhe bien në kundërshtim me faktet, provat e analizuara.

Për rrjedhojë, Komisioneri arrin në përfundimin se fëmija i subjektit ankues i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me mospërfshirjen e tij në listën e përfituesve të bursës, me fondet e Bashkisë, sipas përcaktimeve të pikës 2.1/c), të VKM-së me nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

B. Shkaku i mbrojtur.

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të gjendjes ekonomike, të pretenduar nga pala ankuese si shkak diskriminimi, duke parashikuar në nenin 1, të tij se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se nxënësi F. H., përfaqësuar përpara Komisionerit nga babai i tij, është diskriminuar për shkak të *gjendjes ekonomike*.

Në parim, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun i pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij.

Komisioneri vlerëson se “gjendja ekonomike” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi parashikohet si i tillë në LMD.

Gjendja ekonomike, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton pastaj në braktisjen e shkollës ose në arritjet e nxënësve.

Komenti i Përgjithshëm nr. 20 “Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore”, i Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara, parashikon: “*Situata sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë mund të rezultojë në diskriminim të përhapur, stigmatizim dhe stereotipe negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike*”.

Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton se: “Ndihma ekonomike”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, dhe se, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.”

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kategoria e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe kanë fëmijë që ndjekin arsimin bazë, është kategori e familjeve në nevojë që e mbartin shkakun e mbrojtur.

Ankuesi ka depozituar dokumentacion me anën e të cilit provon shkakun e gjendjes ekonomike:

- Referuar “Vërtetimit” datë 09.10.2024 të Bashkisë Korçë, për familjen e z. F. H., vërtetohet fakti se është një familje e cila trajtohet me ndihmë ekonomike në Njësinë Administrative Nr. 3, në shumën 6380 lekë.
- Referuar çertifikatës familjare, lëshuar në datën 09.10.2024, nga Zyra e Gjendjes Civile, Njësia Administrative Korçë, familja e ankuesit, përbëhet nga 4 (katë) pjesëtarë, z. F. H., znj. A. H.,

bashkëshortja e tij, si dhe fëmijët: E. H., i datëlindjes 02.12.2006 dhe F. H., i datëlindjes 08.05.2012.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim duhet të shqyrtohet bazuar në shkakun e *gjendjes ekonomike*, pasi konsiderohet i provuar mbështetur në provat dhe faktet e administruara.

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

C.1 Lidhja e trajtimit të padrejtë e të pafavorshëm, me shkakun e gjendjes ekonomike.

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: *“1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligjje e arsyeshme dhe objektive”.*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të i KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminim” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet⁸.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat

⁸ Shih: Molla kundër Greqisë, Vendim i Dhomës së Madhe, 2018, prg. 135; Fábíán kundër Hungarisë, Vendim i Dhomës së Madhe 2017, prg. 113; Abdulaziz, Cabales dhe Balkandali kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1985, prg.72.

situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme⁹. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme¹⁰. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14¹¹.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 të tij, ka parashikuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”*

Në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Në nenin 6, të LMD përcaktohet se: *“Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku

⁹ Shih: Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹⁰ Shih: Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

¹¹ Shih: Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen Thlimmenos, cituar më lart, prg. 44; Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

sanksionohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”.

Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit e bën edhe Kodi i Procedurave Administrative, duke parashikuar në nenin 82, pika 2, si vijon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi prima facie), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njëren nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹²

Komisioneri çmon të nevojshme të theksojë se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në konkluzion të analizës sa më sipër, Komisioneri ka arritur në përfundimin se, nxënësi F. H., respektivisht, është nxënës në shkollën 9-vjeçare “Ismail Qemali”, Korçë, fëmijë i një familjeje që, trajtohet me ndihmë ekonomike, i është nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm, nga ana e Bashkisë Korçë, lidhur me përjashtimin nga e drejta e përfitimit të bursës, bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c), të VKM-së me nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit

¹² https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar. Në këto kushte, mbetet që të vlerësohet nëse për këtë diferencë në trajtim ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i Këshillit të Ministrave për trajtimin me bursë të nxënësve, familjet e të cilëve janë në pamundësi financiare, pasi janë familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, është i ligjshëm, pasi synon mbështetjen e tyre.

Identifikimi i shkakut të diskriminimit dhe analizimi i tij në një çështje diskriminimi është mjaft i rëndësishëm, jo thjesht për të konstatuar diskriminimin, por edhe për të dhënë një vendim sa më efektiv. Në çështjen në shqyrtim, Komisioneri ka identifikuar dhe vlerësuar se subjekti ankues posedon një shkak të mbrojtur nga LMD, atë të “*gjendjes ekonomike*”.

E drejta për arsim, është një e drejtë themelore e njeriut, e sanksionuar në nenin 57¹³ të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë qasje në regjistrimin apo ndjekjen e arsimit e për rrjedhojë do të jenë përherë në kushtet e braktisjes së shkollës.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t’u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës¹⁴, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t’u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta dhe shtetet palë duhet të marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

Ligji 69/2012 “*Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar¹⁵, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t’i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se Këshilli i Ministrave për të garantuar të drejtën për arsim të të gjithë fëmijëve, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike apo që për arsye e shkaqe të tjera objektive janë konsideruar si pjesë e grupeve vulnerabël, si nga pushteti qendror dhe ai vendor, ka parashikuar trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve që i përkasin kësaj kategorie, të konsideruar vulnerabël.

¹³ 1. Kushdo ka të drejtën për arsimim.5. Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.

¹⁴ Neni 28 i Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës¹⁴: 1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata: e) Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

¹⁵ Neni 5. E drejta për arsimim. 1. Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, moshë, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

Bashkia Korçë ka pasur barrën e provës¹⁶ para Komisionerit për të provuar se pavarësisht faktit se familja e nxënësit F. H., trajtohet me ndihmë ekonomike, ka një justifikim të arsyeshëm e objektiv për përjashtimin e tyre nga bursa.

Komisioneri gjen të padrejtë e të pajustificuar qëndrimin e Bashkisë, lidhur me përjashtimin e fëmijës së ankuesit nga përfitimi i bursës, së pari se, Bashkia është në dijeni të kushteve ekonomiko-sociale të familjes së nxënësit, pasi ai rezulton aplikues të bursës edhe për vitet e mëparshme shkollore, fakt i deklaruar nga vetë Bashkia dhe i konstatuar nga Komisioneri në Vendimin nr. 141, datë 20.05.2024. Së dyti, Komisioneri vlerëson se, kërkimi i dokumentacionit, i cili disponohet nga ana e saj, dhe bazuar mbi të cilin i njeh dhe bën pagesën e ndihmës ekonomike për familjen e z. F. H., është një pengesë e shtuar dhe barrë e tepërt për aplikantin për efekt të përfitimit të bursës bazuar në kriterin 2.1/c, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar. Është detyrim dhe diskrecion i saj për sigurimin e disponimin e dokumentacionit të prodhuar e administruar prej saj.

Trajtimi i familjes së z. F. H., me pagesë të ndihmës ekonomike dhe rifreskimi i gjendjes social ekonomike çdo 3 (tre) muaj nga ana e Bashkisë, automatikisht të çon në pasjen dijeni prej saj, të ardhurave të pamjaftueshme të kësaj familjeje.

Përfundimisht, Komisioneri vlerëson se, fëmija i ankuesit, bazuar në kriterin ekonomik të VKM-së përkatëse, duhet të ishte përfitues i bursës, si fëmijë i një familjeje në nevojë, njohur, pranuar dhe dëshmuar me dokumentacion (vërtetim për trajtimin me ndihmë ekonomike) prej Bashkisë Korçë.

Komisioneri vlerëson se nga informacionet e dërguara nga ana e Bashkisë, në asnjë rast nuk u arrit të provohej:

- Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga pala ankuese, që është gjendja ekonomike dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e bashkisë, të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
- Që veprimet dhe mosveprimet e këtij subjekti kundrejt palës ankuese janë në përputhje me parashikimet ligjore, të drejta, objektive dhe të arsyeshme.

Për rrjedhojë, Komisioneri gjykon se:

- Kërkesa e Bashkisë Korçë lidhur me dokumentacionin që duhet dorëzuar nga aplikanti sipas kriteve të pikës 2.1/c, të VKM-së sipër cituar, konkretisht të *vërtetim regjistrimi si punëkërkues i papunë për çdo anëtarë madhor të familjes*, të cilin ajo e disponon në dosjen e personit që përfiton pagesën e ndihmës ekonomike, është kërkesë e tepërt dhe e panevojshme duke qenë se administrohet prej saj, si dhe krijon për aplikantin një barrë të tepërt.
- Veprimet e ndjekura nga Bashkia Korçë dhe justifikimi i dhënë prej saj për mospranimin e dokumentacionit, për pasojë dhe mospërfitimit të bursës nga ana e fëmijës të z. F. H., janë tërësisht të pabazuara, të pajustificuara, jo objektive dhe të padrejta. Ato janë haptazi në

¹⁶ Në referencë të neni 82, pikat 2 dhe 3 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe pika 7/1, e nenit 33, të LMD-së.

kundërshtim me parashikimin ligjor të VKM-së së analizuar, si dhe me parimin e mosdiskriminimit dhe interesit më të lartë të fëmijës.

Bazuar në të dhënat e analizuara në vendim, Komisioneri vëren se, nxënësi në fjalë, plotëson kriterin e cilësuar në pikën 2.1/c, të VKM-së përkatëse, dhe ky fakt është i njohur dhe pranohet nga ana e Bashkisë, pasi pikërisht për këtë arsye ai është dhe përfituese e ndihmës ekonomike nga strukturat e saj.

Neni 3/2 i ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ka përcaktuar se konsiderohet si “Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji.

Për sa më sipër, Komisioneri konstaton se fëmija i ankuesit, si anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike, është vënë në pozita jo të favorshme, duke i mohuar mundësinë për të përfituar bursë, me qëllim sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës për të, si pjesë e kategorisë së nxënësve përfitues. Pra, fëmija i ankuesit është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, nga ana e Bashkisë Korçë, për shkak të gjendjes ekonomike të familjes së tij.

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030, ka si vizion¹⁷ mbrojtjen sociale në një mjedis mundësues dhe fuqizues për çdo individ në nevojë, duke garantuar jetesë dinjitoze përgjatë ciklit të jetës.

Një nga objektivat specifik/strategjik¹⁸ të kësaj Strategjie është edhe *“përmirësimi i shënjestrimit të fëmijëve, vajza dhe djem përmes skemave financiare të ndjeshme gjinore dhe një programi mbrojtje sociale me fokus fëmijët. Përmirësimi përfitimeve dhe bashkëpunimit ndër-sektorial me fokus fëmijët, vajzat dhe djemtë në skemën e ndihmës ekonomike me synim promovimin e mirëqenies së tyre.”*

Ky dokument, ndër të tjera citon se: *“Analiza të mëparshme kanë theksuar nevojën për të ofruar mbështetje të mëtejshme për familjet me fëmijë (të vegjël) në kushtet e pamjaftueshmërisë së skemave ekzistuese të mbështetjes në para dhe përfitimeve të tjera. Aktualisht ekzistojnë disa përfitime për përmirësimin e mirëqenies së fëmijëve në familjet në ndihmë ekonomike. Të tilla janë bonusi i bebes për çdo fëmijë të lindur, stimuli financiar për regjistrimin në shkollë dhe për vaksinimin, tekste shkollore falas, bursa mësimore etj. Ekzistojnë dhe shërbime të tjera që merren nga një sërë institucionesh lokale dhe qendrore të cilat duhen identifikuar dhe analizuar. Evidentimi i të gjithë llojeve të përfitimeve dhe shërbimeve, analiza e kostove që lidhen me mirërritjen e fëmijëve do të mundësojnë ndërtimin e skenarëve të ndryshëm për të përmirësuar këto përfitime. Ekzistojnë modele dhe praktika ndërkombëtare mbështetjeje me përfitime për fëmijët në*

¹⁷ 3.1 Vizioni

¹⁸ Objektivi specifik/strategjik A3.

familjet në ndihmë ekonomike, të cilat do të njihen dhe do të përdoren për ndërtimin e skenarëve të mbështetjes për fëmijët në të ardhmen. Analiza të vijueshme për impaktin e këtyre skemave në mirëqenien e fëmijëve do të kryhen me qëllim realizimin e modifikimeve të nevojshme.”

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030, lidhur me forcimin e bashkëpunimit ndërsektorial me fokus fëmijët në programin e NE-së, citon se: “*Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka hedhur hapa të rëndësishëm dhe konkret drejt një modeli të shërbimeve të integruara shëndetësore dhe të mbrojtjes sociale për fëmijët përfitues të skemës së ndihmës ekonomike. Njëkohësisht lidhja me arsimimin është thelbësore për të garantuar të drejtën e fëmijëve në nevojë për siguruar qëndrimin në shkollë. Në veçanti, orientimi drejt një modeli të koordinuar mes shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësor pritet të jetë një prej prioriteteve të strategjisë së re për garantimin e mbështetjes së fëmijëve dhe familjeve. Ky integrim i shërbimeve nis që në moshën 0-5 vjeç me paketën bazë të shëndetit të kujdesit parësor dhe programit të vizitave të integruara në familje si një mundësi për të adresuar në veçanti fëmijët vulnerabël, monitorimin e zhvillimit të hershëm dhe identifikimit të hershëm të aftësisë së kufizuar si dhe nxitjen e bashkëpunimit ndërsektorial për të siguruar ndjekjen e treguesve të zhvillimit të fëmijës. Ky program aktualisht po zbatohet në qarqet Tiranë, Korçë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Kukës, Berat dhe synimi është të zgjerohet në të gjithë territorin.*

Hartimi i protokolleve të përbashkëta, organizimi i tryezave të përbashkëta në nivel rajonal mes shërbimeve sociale dhe atyre shëndetësore si dhe ngritja e kapaciteteve të personelit socio-shëndetësor do të jenë në fokus në strategjinë e re. Njëkohësisht, pjesë e kësaj mase prioritare do të jetë vlerësimi i fizibilitetit, kapaciteteve institucionale dhe personelit për të hartuar një Plan Veprimi për Garancinë e Fëmijëve sipas modelit dhe udhëzimeve të Bashkimit Evropian. Hartimi i një Plani Veprimi për Garancinë e Fëmijëve është një prej rekomandimeve të Bashkimit Evropian si pjesë e kapitullit 19 për hapjen e negociatave si dhe në përputhje me kapitullin 23 për të drejtat e njeriut. Plani i Veprimit për Garancinë e Fëmijëve, aktualisht po zbatohet në një sërë vendesh të Bashkimit Evropian, dhe ashtu sikurse Plani i Garancisë Rinore do të synojë të ndërtojë modele, mjete dhe financim për adresimin e fëmijëve vulnerabël, të garantojë një plan për reduktimin e varfërisë së fëmijëve dhe nxitur mirëqenien e tyre.”

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare për Arsimin 2021-2026¹⁹, në vizionin e tij ka: “*Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimi gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.”*

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër objektivat e saj specifik ka parashikuar dhe objektivin specifik A.2, ku citohet: “*Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë*

¹⁹ Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 22.10.2021.

nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t'u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë;...”

Gjithashtu, Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër të tjera synon të sigurojë një kujdes të veçantë vajzave dhe djemve në rrezik braktisje, si dhe atyre nga grupet vulnerabël: fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe, në përgjithësi, nga grupet shoqërore të marginalizuara, vajzave dhe djemve që rikthehen nga emigracioni, fëmijët viktime dhe viktime të mundshme të trafikimit, fëmijëve në konflikt me ligjin, si dhe pjesëtarëve të pakicave kombëtare rome dhe egjiptiane²⁰.

Në analizë për sa më sipër, me miratimin e këtij dokumenti strategjik, Qeveria shqiptare merr përsipër obligimin të sigurojë përfshirjen sociale, ekonomike dhe kulturore, ndër të tjera edhe paketa mbështetëse për arsimimin e fëmijëve që vijnë nga familje në nevojë duke i garantuar atyre një jetesë sa më dinjitoze.

Komisioneri vlerëson se, në të njëjtën linjë dhe në harmoni me sa më sipër, duhet të jenë dhe veprimet e masat e ndërmarra nga ana e Bashkisë, lidhur me këto kategori, veprime të cilat përveçse në respektim të kuadrit ligjor, duhet të kenë në konsideratë edhe parimin njerëzor dhe trajtimin me ndjeshmëri të veçantë, pikërisht për shkak të vulnerabilitetit të tyre.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa bazuar në nenin 33, pika 12, të Ligjit “*Për mbrojtjen nga diskriminimi*”, të ndryshuar, përcaktohet: “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”.

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, në nenin 33/10 të tij, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktime të diskriminimit.

Ligji “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson si masë të duhur për rregullimin e situatës, marrjen e masave të menjëhershme nga Bashkia Korçë, si institucioni përgjegjës, për trajtimin me bursë të nxënësit F. H., si fëmijë që vjen nga një familje, që trajtohet me ndihmë ekonomike dhe që ndjek arsimin parauniversitar me kohë të plotë në institucionet arsimore publike.

²⁰ Paragrafi i fundit i faqes 61, të Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021-2026.

Komisioneri ka trajtuar edhe raste, ankesa të tjera të ngjashme me çështjen e fëmijës së ankuesit, por edhe vetë rastin e z. F. H., lidhur me mospërfitimin e bursës nga ana e Bashkisë Korçë, duke dalë me vendimmarrjet respektive.

Po ashtu, Komisioneri sjell në vëmendje të Bashkisë Korçë, që të marrë masa konkrete dhe efektive për përfshirjen e të gjithë nxënësve që ndjekin arsimin bazë dhe që përfshihen në kategorinë e nxënësve që duhet të përfitojnë bursë, gjatë periudhës së ndjekjes së shkollës.

A.1 Lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga NSHMAÇ/Bashkia Korçë për aplikuesit për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike dhe procedurën e ndjekur nga institucionet.

Bazuar në dokumentacionin e depozituar dhe nga deklaratimet e palëve, rezulton se NSHMAÇ/Bashkia Korçë nuk kanë një akt administrativ të miratuar nga institucionet (Bashkia Korçë apo Këshilli Bashkiak Korçë) në të cilin të parashikohet/përcaktohet lista e dokumenteve të kërkuara për aplikim për bursë, si dhe procedura që ndiqet për informimin, dorëzimin, shqyrtimin, plotësimin dhe miratimin e aplikimeve për bursë.

Gjatë trajtimit të ankesave, Komisioneri ka evidentur faktin se një pjesë e dokumentacionit të kërkuar aplikuesve, nga NSHMAÇ/Bashkia Korçë, si në rastet kur aplikuesit trajtohen me ndihmë ekonomike, pagesë paaftësie apo kanë statusin e jetimit, NSHMAÇ ka kërkuar dokumentacion që disponohet nga institucionet vartëse të Bashkisë, dhe në këto raste, mosdorëzimi i këtyre dokumenteve nga aplikuesit ka rezultuar në përjashtimin e aplikimeve për bursë.

Në përfundim, *së pari*, Komisioneri vlerëson se Bashkia Korçë, për rregullimin e situatave të ngjashme në të ardhmen, duhet të marrë masa për miratimin e një akti administrativ, ku të jenë përcaktuar qartë kriteret dhe dokumentacioni përkatës për përfitimin e bursave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar.

Së dyti, nisur nga rastet e trajtuara më parë nga KMD, është evidentuar vendosja e një praktike të gabuar nga ana e Drejtorëve të shkollave, për administrimin dhe përcjelljen e dokumentacionit të aplikantëve si pjesë e kategorisë përfituese të bursës, në NSHMAÇ, pranë Bashkisë Korçë. Sakaq, për rregullimin e situatave të ngjashme në të ardhmen, duhen marrë masat e nevojshme që aplikantët për trajtimin me bursa, të pajisen me një dokument i cili vërteton faktin e aplikimit, dokumentacionit të dorëzuar dhe për cilën kategori përfituese të VKM-së nr. nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, ka aplikuar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 1, nenin 7/1, nenin 11, nenin 18/1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënësit F. H.,²¹, për shkak të gjendjes ekonomike, nga ana e Bashkisë Korçë, si fëmijë i një familjeje që trajtohet me ndihmë ekonomike.
2. Bashkia Korçë të marrë masa efektive, për trajtimin me bursë, për vitin shkollor 2024-2025, të nxënësit F. H., bazuar në kriterin ekonomik, sipas pikës 2.1/c, të VKM nr. nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
3. Me qëllim për të shmangur situata të tjera të ngjashme, si në rastin konkret, rekomandohet Bashkia Korçë, të marrë masa paraprake efektive, për rregullimin e situatave të tilla.
4. Rekomandohet që Bashkia Korçë, të marrë masa për:
 - miratimin e një akti administrativ ku të jenë përcaktuar qartë kriteret dhe dokumentacioni përkatës për përfitimin e bursave, sipas parashikimeve të VKM-së nr. nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar;
 - miratimin e një procedure të qartë për trajtimin me bursa ku aplikantët të pajisen me një dokument, përmes së cilit të vërtetohet fakti i aplikimit, dorëzimit të dokumentacionit përkatës dhe kërkesa për përfitimin nga kriteri specifik sipas VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
5. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Bashkia Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
6. Në referim të nenit 33, pika 13, të Ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

²¹ Përfaqësuar nga babai, z. F. H.

Punoi: L.Jani
Pranoi: V. Bushati
Datë: 05.05.2025